

Tiranë më, 27.07.2023

Në lidhje me deklaratën e aplikantit AGRO DESCO SH.P.K., Thirrja III, Programi IPARD II, Skualifikimi i aplikimit për mbështetje nga IPARD, AZHBR: Nuk plotësoi kriteret e afatit për dorëzimin e dokumentave të kërkuara.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) sqaron opinionin publik në lidhje me një shkrim të publikuar në disa media, për skualifikimin e aplikimit të subjektit AGRO DESCO SH.P.K., për mbështetje nga programin IPARD II, Masa 1.

AZHBR shpreh keqardhje që nuk është pyetur për rastin në fjalë, informacion i cili do t'i shërbente transparencës së informimit të publikut.

Aplikanti nuk ka plotësuar kriteret e programit të përcaktuara në udhëzuesin për aplikantë, për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 15 ditë pune, kërkuar nga AZHBR me shkresë nr. 602/4, datë 15/07/2021.

Bazuar në Marrëveshjen Sektoriale të Ratifikuar, Programin IPARD II, dhe Udhëzuesin për aplikantë <https://azhbr.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Udhezuesi-per-Aplikantet-Shqip-1.pdf>, Kapitulli 8, 'Shënime të rëndësishme për aplikantin lidhur me refuzimin e aplikimeve', Pika B, fq. 36, për gabime më të vogla do të kërkohen sqarime/ridërgim të dokumenteve që mungojnë.

Aplikantit do t'i jepet një afat prej 15 ditor pune për të ridorëzuar të gjitha dokumentet që mungojnë, dhe nëse dokumentet nuk dorëzohen brenda këtij afati apo nëse ato do të jenë sërish të paplota, aplikimi do të refuzohet.

Sa më lart, nga struktura zbatuese e Programit IPARD është respektuar procedura ligjore dhe nuk ka asnjë shkelje administrative.

AZHBR si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga BE, është fokusuar në zhvillimin e një Bujqësie të qëndrueshme dhe diversifikimin e ekonomisë Rurale, nëpërmjet granteve që përfitohen nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Evropian duke zbatuar me përpikmëri kriteret e vendosura nga BE për aplikantët.